



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.4.7-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË FONDIT TË BASHKUAR PËR
SEKTORIN E ARSIMIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Auditim në bazë të marrëveshjes me MASHT/FBSA

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Fondit të Bashkuar në Sektorin e Arsimit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Igballe Halili dhe Arnisa Aliu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	9
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	13
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	14

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje


Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i raportit vjetor financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit (tutje FBSA) për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë stafin e Ministrisë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Fondi i Përbashkët në Sektorin e Arsimit është një fond i themeluar nga një grup i Partnerëve për Zhvillim në Kosovë, si një mekanizëm i përbashkët i financimit për të kanalizuar burimet/resurset e tyre në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm të arsimit në Kosovë. Qëllimi i tij është të harmonizojë mbështetjen e jashtme për sektorin, duke shfrytëzuar sistemet e qeverisë, dhe për të harmonizuar modalitetet e ndihmes të partnerëve të zhvillimit në mënyrë që kostot e transaksionit të reduktohen. Ky fond është krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të, Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritimit Evropian) dhe Partnerëve për Zhvillim (Suedisë/SIDA dhe Agjencisë për Zhvillim të Austrisë). Kohëzgjatja e paraparë e projektit ishte 2013-2015, dhe kishte për qëllim mbështetjen e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencionet e saj qendrore në implementimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë me theks të veçantë në komponentën - ndërtimi i kapaciteteve.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ishte përgjegjëse për implementimin e këtij projekti, duke përfshirë edhe raportimin tek komiteti drejtues i projektit. Realizimi i projektit është asistuar nga partnerët zhvillues nëpërmjet tre këshilltarëve, një i financuar nga GIZ (Gjermani) dhe dy nga Sida (Suedi).

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opiniononi

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opiniononi i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat financiare (raporti financiar vjetor) *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në pjesët individuale të shpalosura brenda këtij raporti konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

- informatat e shpalosura në Raportin Vjetor Financiar janë të sakta dhe në pajtim me kornizën raportuese; dhe
- menaxhimi financiar dhe kontrollet kanë funksionuar kryesisht në mënyrë efikase, me disa vërejtje të vogla.

Në aspektin e menaxhimit financiar të projektit 73% e shpenzimeve të planifikuara janë realizuar. Gjatë planifikimit të projektit nuk ishin parashikuar të gjitha rrethanat që mund të ngadalësonin ecurinë e projektit në fazën e implementimit. Një pjesë e aktiviteteve të parapara në projekt nuk janë implementuar, derisa ka pasur edhe financim të aktiviteteve jashtë planit nga mjetet e projektit. Si pasojë e dinamikës së ngadalshme të realizimit, komiteti drejtues i projektit e ka vlerësuar të nevojshme, dhe kohëzgjatja e projektit është zgjatur deri në fund të vitit 2016.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Poashtu ne konsiderojmë edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Projektit MASHT/FBSA të cilat përfshijnë, një përmbledhje të krahasimit të buxhetit me shumat aktuale dhe shënimet shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare/raporti financiar paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të gjendjes financiare të shpalosur të Projektit MASHT/FBSA për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme) dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është e pavarur nga MASHT/FBSA dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i MASHT është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollen të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi

apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm dhe Komiteti Drejtues i MASHT/FBSA janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Projektit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Një përshkrim i mëtejshëm i përgjegjësive të auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të MASHT/FBSA është vendosur në marrëveshjen e nënshkruar nga Auditori i Përgjithshëm dhe Kryesuesi i Komitetit Drejtues të MASHT/FBSA.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MASHT/FBSA, sipas marrëveshjes për themelim kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar ligjore, dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048(me plotësime dhe ndryshime) ; dhe
- Rregulloret e thesarit në lidhje me shpenzimin e parave publike.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në lidhje me fondet e shpenzuara nga MASHT/FBSA është përgatitur raporti përmbledhës, derisa ky raport më tej është përfshirë edhe në Pasqyrat Vjetore Financiare të “Konsoliduara” të MASHT-it. Në lidhje me progresin e projektit është raportuar në baza të rregullta tremujore.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, dhe sa i përket performancës së projektit ne kemi vërejtur se akoma nuk është përgatitur raporti vjetor i performancës, për vitin 2015 derisa projekti nuk është përfunduar në tërësi, dhe afati i përfundimit është zgjatur deri në fund të vitit 2016.

Rekomandimi

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** – Komiteti drejtues duhet të siguroj që për pjesën e mbetur të shpenzimeve të bartura për vitin 2016 të përgatitet një raport detal dhe t’i dërgohet partnerëve participues në projekt për të siguruar se buxheti është shfrytëzuar për qëllimet e synuara dhe në harmoni me rregullat e kërkuara. Për auditimin e kësaj pjese të shpenzimeve duhet të bëhet një aneks kontratë me ZAP apo të kontraktohet ndonjë kompani tjetër, varësisht nga ajo se si vendos Komiteti Drejtues dhe Partnerët.

2 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF të vitit 2014 të MASHT/FBSA ka rezultuar në një rekomandim kryesor. Rekomandimi kishte të bëjë më nivelin e ulët të realizimit të projektit/shpenzimeve. Komiteti Drejtues dhe MASHT me gjithë zotimin e bërë nuk kishin përgatitur ndonjë plan veprimi. Megjithatë janë marrë masat e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi, dhe si rezultat buxheti gjatë vitit 2015 ishte realizuar në nivelin 73% të buxhetit të planifikuar.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne kemi konsideruar menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe procesin e pagesave.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MASHT/FBSA, nuk kemi ndonjë shqetësim për të theksuar, dhe rregulloret e kërkuara janë zbatuar. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të forta dhe janë zbatuar në mënyrë efektive me disa vërejtje të vogla sa i përket shpenzimeve jashtë planit dhe disa shpenzime të vogla të paarsyeshme. Kontrollet sa i përket realizimit me kohë të projektit nuk kanë funksionuar mirë. Si rezultat projekti edhe pse ishte paraparë të përfundojë në vitin 2015, është zgjatur deri në fund të vitit 2016.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MASHT/FBSA, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. MASHT/FBSA kishte dy burime të fondeve: nga SIDA Suedeze dhe ADA Austriake. Sa i përket kategorive ekonomike, të gjitha shpenzimet e MASHT/FBSA ndërlidhen me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shpenzimet e ndodhura dhe krahasimi me buxhetin janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Burimet	Buxheti 2015	Shpenzimet 2015
SIDA	1,156,341	821,174
ADA	109,678	100,988
Total	1,266,020	922,162

Tabela 2. Fondet buxhetore sipas nënprogrameve - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti i alokuar - 2015	Shpenzimet e buxhetit për 2015	Pjesa e pashpenzuar
Asistenca Teknike për MASHT	1,051,165	788,272	262,893
Shpenzimet e paparashikuara	150,000	107,807	42,192
Kurset e gjuhës angleze	55,305	19,536	35,769
Procesi i QTS - Rishikimi i Përbashkët Vjetor	4,550	4,327	223
Verifikimi i buxhetit/auditimi i FBSA	5,000	2,220	2,780
Totali	1,266,020	922,162	343,858

Në vitin 2015, MASHT/FBSA ka përdorur 73% të buxhet ose 922,162€, me një përmirësim prej 45% krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit dhe projektit në përgjithësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm duke pasur parasysh se në bazë të marrëveshjes për themelimin e fondit ky projekt është planifikuar të përfundojë në vitin 2015. Poashtu disa nga objektivat e planifikuara të projektit nuk janë arritur.

Çështja 2 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit edhe pse është përmirësuar dukshëm në krahasim me vitin paraprak, nuk ishte akoma në nivelin e pritur. Edhe dinamika e shpenzimeve nuk ishte e mirë, pasi që rreth 33% e shpenzimeve vjetore kanë ndodhur në muajin e fundit të vitit.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i aktiviteteve financiare dhe realizimit i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të projektit. Për shkak të ngarkesës që shkakton rritja e volumit të pagesave në fund të vitit, mund të vijë deri te situata kur pagesat kryhen në mungesë të aplikimit të kontrolleve të nevojshme dhe si pasojë mund të ndodhin gabime.
- Rekomandimi 2** Komiteti Drejtues duhet të sigurojë që realizimi i buxhetit dhe aktiviteteve të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore, duke identifikuar dhe adresuar barrierat që ndikojnë në realizimin e buxhetit.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet e ndodhura përmes procedurave të prokurimit ishin mbi 840,000€ në 2015. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Kontrata kryesore që ndërlihet me projektin (Asistenca teknike për MASHT) ishte nënshkruar në vitin 2014 derisa gjatë vitit 2015 janë bërë disa kontrata më të vogla si psh. rasti i shtimit të dy niveleve në sistemin SMIA, dizajnimin e web faqes së MASHT etj. Procedurat e prokurimit janë zhvilluar në pajtim me rregullat vendore të prokurimit publik dhe janë përkrahur nga ekspertë të financuar nga GIZ. Ne kemi testuar 8 pagesa që ndërlihen me prokurimin në vlerë prej 816,632€.

Çështja 3 Humbje nga mosanulimi i biletës së udhëtimit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në kuadër të projektit ishte realizuar një udhëtim zyrtar, ku kanë marrë pjesë 10 zyrtarë të Ministrisë për vizitë studimore. Fillimisht ishin rezervuar 10 bileta të aeroplanit. Mirëpo, njëri zyrtar ishte tërhequr nga udhëtimi i planifikuar dhe për këtë e kishte njoftuar bartësin e projektit, me kohë. Megjithatë bileta nuk është anuluar edhe pse (sipas kontratës) kishte mundësi dhe kohë të mjaftueshme për anulim. Si rezultat janë paguar rreth 600€ pa nevojë.
- Rreziku** Pagesat e paarsyeshme të shpenzimeve për shërbime të cilat nuk janë marrë, janë në kundërshtim me parimet e menaxhimit efektiv të buxhetit dhe shkaktojnë humbje financiare.
- Rekomandimi 3** Këshilli Drejtues duhet të kërkojë nga zyrtarët e përfshirë në menaxhimin e aktiviteteve të projektit që të jenë më të vemëndshëm gjatë menaxhimit të aktiviteteve për të shmangur shpenzimet e panevojshme.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet për udhëtime, trajnimet etj.

Te kjo pjesë janë përfshirë shpenzimet që nuk kanë nevojë për zhvillim të procedurave të prokurimit. Pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë me udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, akomodimin dhe shpenzimet e trajnimit. Nga kjo kategori e shpenzimeve, në bazë të mostrimit kemi testuar 10 pagesa në vlerë prej 66,593€.

Çështja 4 Financimi i aktiviteteve jashtë synimeve të projektit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Mjetet e projektit/fondit janë përdorur edhe për financimin e aktiviteteve që nuk ishin pjesë e projektit. Për elaborim mund të përmendim një rast kur akomodimi i dy pjesëmarrësve të huaj në “Javën e Shkencës” në vlerë prej 862€, është financuar nga mjetet e fondit. Përdorimi i mjeteve për këtë qëllim është aprovuar nga Sekretari i Përgjithshëm/Kryesuesi i Komitetit Drejtues.
- Rreziku** Përdorimi i mjeteve për financimin e aktiviteteve që nuk janë pjesë e planit të punës rrit rrezikun që aktivitetet e planifikuar të mos realizohen sipas planit dhe të mos arrihen objektivat e projektit.
- Rekomandimi 4** Komiteti Drejtues duhet të sigurojë që nga mjetet e projektit të financohen që vetëm aktivitetet e planifikuara. Për çdo ndryshim eventual duhet të vendos Komiteti Drejtues pas marrjes së pëlqimit nga partnerët donator.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Komiteti Drejtues i Projektit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet , ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes